

Rreth Bebras

Bebras Computing Challenge (Kastori i Informatikës) është një iniciativë ndërkombëtare që synon të promovojë informatikën dhe të menduarit kompjuterik ndër nxënës.

Bebras Computing Challenge është krijuar për të ndihmuar nxënësit të eksplorojnë talentet dhe pasionin e tyre për informatikën dhe të menduarit kompjuterik, përmes zgjidhjes së enigmave dhe sfidave atraktive.

Qëllimi i Bebras Computing Challenge

Qëllim i kësaj sfide është:

- T'i emocionojë nxënësit në të gjithë botën për menduarit algoritmik dhe kompjuterik
- Të kultivojë kreativitetin e nxënësit, aftësinë e arsytimit logjik, aftësitë e të menduarit algoritmik dhe llogaritës
- Të prezantohet të menduarit kompjuterik si një aftësi themelore e të mësuarit të shekullit të 21-të, ashtu si aftësitë e leximit, shkrimit dhe matematikës
- Të krijojë një kuptim më të thellë për zgjidhjen e problemeve të përditshme duke shfrytëzuar fuqinë e kompjuterëve dhe teknologjisë së informacionit
- T'i inkurajojë nxënësit të përdorin teknologjinë e informacionit në aktivitetet e tyre mësimore më me entuziazëm
- T'ua qartësoj nxënësve përparësitë e TIK-ut në mësim, jeta dhe puna
- Ti nxisë nxënësit të angazhohen në informatikë, shkencë kompjuterike
- T'u ndihmojë nxënësve t'i zbulojnë avantazhet e teknologjisë së informacionit dhe t'ua rris motivimin për mësimin e lëndëve të ndryshme
- Promovimi i informatikës dhe të menduarit algoritmik dhe kompjuterik si njohuri të përgjithshme.

Si funksionon sfida e “Kastorit të Informatikës,, dhe kush mund të përfshihet në këtë iniciativë ndërkombëtare?

Në garën Bebras Computing Challenge, nxënësit nga mosha 8 deri në 18 vjeç do t'i zgjidhin një sërë detyrash që fokusohen në tema dhe aftësi të ndryshme nga fusha e informatikës dhe të menduarit algoritmik dhe kompjuterik. Nxënësit do të kenë 35 minuta për të kryer sa më shumë detyra që të mundën. Sfida është e organizuar në pesë kategori të ndryshme moshe, për t'i mbajtur gjërat emocionuese dhe sfiduese për të gjithë nxënësit:

- Kastorët (mosha 8-10, klasa 3 dhe 4)
- Benjaminët (mosha 10-12, klasa 5 dhe 6)
- Kadetët (mosha 12-14, klasa 7 dhe 8)
- Juniorët (mosha 14-16, klasa 9 dhe 10)
- Seniorët (mosha 16-18, klasa 11 dhe 12)

Secila kategori do t'i ketë nga 9 detyra, të ndara në tri nivele të ndryshme vështirësie (lehtë-mesatare-vështirë) me nga 3 detyra për secilin nivel. Numri total i pikëve që mund të arrihen në Bebras Computing Challenge është 81.

Pyetjet janë në formën e enigmave tërheqëse që nisin relativisht lehtë, kështu që çdo nxënës mund të marr pjesë dhe të përfitoj nga kjo garë. Nxënësit nuk duhet të përgatisin ose praktikojnë asgjë për sfidën.

Sfida kryhet në shkolla duke përdorur kompjuterë. Konkurrentët zakonisht mbikëqyren nga mësuesit dhe koordinatorët e sfidës në nivel shkolle.

Rekomandohet që nxënësit pjesëmarrës në sfidë të përzgjedhen në mënyrë vullnetare nga grup-mosha përkatëse, p.sh. nxënësit e paraleleve të klasave III-ta dhe të IV-ta formojnë një grup prej 25 pjesëmarrësve për këtë sfidë në nivelin “Kastorët”.

Për të gjithë pjesëmarrësit do të shpërndahen certifikata të pjesëmarrjes dhe online badges.

Llojet e certifikatave

SHPIK beson se çdo pjesëmarrës në Bebras Computing Challenge 2023 meriton mirënjohje, por ne po ashtu synojmë të veçojmë dhe kremtojmë shkathësitë e të menduarit algoritmik dhe kompjuterik. Sistemi i certifikatave të Bebras Computing Challenge është krijuar për të njohur një gamë të gjerë arritjesh.

Certifikata e pjesëmarrjes

Çdo student që përfundon me sukses sfidën do të marrë një 'Certifikatë Pjesëmarrjeje'. Nxënësit që shënojnë mbi përqindjen e 50-të do të nderohen me 'Certifikatë Meritash'.

Pjesëmarrësit që tregojnë një zotërim të jashtëzakonshëm të të menduarit algoritmik dhe kompjuterik, duke shënuar pikë mbi përqindjen e 75-të, do të nderohen me "Certifikatë Excellence".

Certifikatat 'Bebras Innovator' , 'Bebras Elite' dhe 'Bebras Mastermind' janë të rezervuara për nivelet më të larta të pjesëmarrësve, duke festuar talentin dhe logjikën e të menduarit algoritmik dhe kompjuterik.

Emrat dhe kriteret e certifikatës:

Certifikata	Pikët
Bebras Certificate of Participation	≤ 40
Bebras Certificate of Merit	41-50
Bebras Certificate of Excellence	51-60
Bebras Innovator Certificate	61-67
Bebras Pinnacle Certificate	68-79
Bebras Mastermind Certificate	80-81

Llojet e certifikatave

- **Bebras Certificate of Participation (≤ 40 Pikë):** Kjo certifikat njih përparësinë e bërë nga pjesëmarrësit. Ku shërben si një njohje e angazhimit fillestar të një pjesëmarrësi në mendimin kompjuterik dhe zgjidhjen e problemeve.
- **Bebras Certificate of Merit (41–50 Pikë):** Kjo certifikat u jepet pjesëmarrësve që kanë demonstruar një kuptim themelor të të menduarit kompjuterik. Kjo certifikatë shërben për të njohur aftësitë e mësipërme bazë dhe inkurajon marrësit që të vazhdojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre.
- **Bebras Certificate of Excellence (51–60 Pikë):** Kjo certifikatë u jepet pjesëmarrësve që kanë treguar një zotërim të shkëlqyeshëm të aftësive të të menduarit kompjuterik dhe zgjidhjes së problemeve. Ai është krijuar për të lavdëruar një grup të fortë aftësish dhe për të inkurajuar eksplorimin dhe studimin e mëtejshëm në këtë fushë.
- **Bebras Innovator Certificate (61–67 Pikë):** Kjo certifikatë është e rezervuar për ata që kanë shfaqur mendim inovativ dhe shkathtësi të avancuara për zgjidhjen e problemeve. Marrësit e kësaj certifikate konsiderohen të pajisur mirë për të përballuar sfidat komplekse dhe për të kontribuar në zgjidhje shpikëse.
- **Bebras Pinnacle Certificate (68–79 Pikë):** Kjo certifikat u jepet shënuesve më të mirë, kjo certifikatë është një mirënjohje e arritjeve të jashtëzakonshme në të menduarit kompjuterik. Marrësit kanë demonstruar një nivel elitare aftësish dhe konsiderohen ndër më të mirët e grupit pjesëmarrës.
- **Bebras Mastermind Certificate (80–81 Pikë):** Ky është niveli më i lartë i njohjes, i dhënë vetëm për pjesëmarrësit me performancën më të mirë. Ai nënkupton jo vetëm zotërimin e të menduarit kompjuterik, por edhe shkathtësitë për të zgjidhur problemet më sfiduese në kushte konkurruese.